



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, në datën 19 prill 2022, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Radio Televizioni Super Sonic” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, tematik muzikor, online mbështetur në internet “STV”. **(Vendimi nr. 35, datë 19.04.2022)**
2. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Radio Televizioni Super Sonic” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, tematik muzikor, online mbështetur në internet “STV Folk”. **(Vendimi nr. 36, datë 19.04.2022)**
3. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “TV Kabllor Vlora Cable” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Vlora Cable”. **(Vendimi nr. 37, datë 19.04.2022)**
4. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Shezai Aliaj, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Vjosa”. **(Vendimi nr. 38, datë 19.04.2022)**
5. Kalimin e të drejtave të autorizimit të subjektit person fizik Gjergj Gega, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Mamurras”, te subjekti person fizik Ardian Gega. **(Vendimi nr. 39, datë 19.04.2022)**
6. Refuzimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Netsyscom” sh.p.k. dhe lënien në fuqi të vendimit të grupit të inspektorëve për dënimin me gjobë nr. 1, datë 12.01.2022 “Për dënimin me gjobë në masën 1 000 000 (një milion) lekë të shoqërisë “Netsyscom” sh.p.k., autorizuar për subjektin OSHMA kabllor “Netsyscom TV”. **(Vendimi nr. 40, datë 19.04.2022)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 19 prill 2022